

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXV, nr. 8011  
E enjte, 13 mars 2025  
Çmimi 0.50 €

Kosova miraton nismën  
për një marrëveshje  
në fushën e mbrojtjes  
me ShBA-në | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## QEVERIA, ENDE E PAARRITSHME

| FAQE 4-5



Zgjedhjet në Kosovë mund të kenë përfunduar, por koha kur vendi do të ketë qeveri të re duket se është

ende larg. Me partitë opozitare që e përjashtojnë bashkëpunimin me Vetëvendosjen dhe me këtë

të fundit që këmbëngul se do ta formojë vetë qeverinë, situata mbetet e hapur për çdo skenar

**NATO  
RIAFIRMON  
ANGAZHIMIN  
PËR STABILITETIN  
NË BALLKANIN  
PERËNDIMOR** | F. 5



**PËRFUNDON RINUMËRIMI I 50  
VENDVOTIMEVE NË QNR** | F. 3



### AKTUALE




**PROKURORIA E BOSNJËS LËSHON  
URDHËR PËR NDALIMIN E DODIKUT** | F. 2

**ÇEKU I REAGON ABDIXHIKUT:  
SI MUND TË BËHESH KRYEMINISTËR  
NË NJË PALË ZGJEDHJE  
QË I KE HUMBUR** | F. 3

**INSPEKTORATI I TRASHËGIMISË  
KULTURORE NDALON PUNIMET  
NË SHESHIN "XHORXH BUSH"  
NË KRYEQYTET** | F. 6

### EKONOMI



**LIBERALIZIMI I TREGUT TË  
ENERGJISË: BIZNESET PËRBALLEN  
ME RRIJTJE TË KOSTOS** | F. 7

### SPORT



**DUKA: NE JEMI BËRË KRENARË QË  
XHAKA LUAN ME ZVICRËN, TANI  
MËRZITEMI PSE BRRUTI LUAN ME  
SHQIPËRINË** | F. 6

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji  
BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Prokuroria e Bosnjës lëshon urdhër për ndalimin e Dodikut

**BANJALLUKË, 12 MARS** - Presidenti i entitetit të Republikës Sërpska (RS), Millorad Dodik, deklaroi në Banjallukë se një "diskurs kundër RS-së" ka filluar nga Sarajeva. Këto deklarata ai i bëri pasi Prokuroria e Bosnjë-Hercegovinës lëshoi një urdhër për ndalimin e tij, me qëllim që ta marrë në pyetje. Urdhër të tillë Prokuroria ka lëshuar edhe ndaj kryeministrit Radovan Vishkoviç dhe kryetarit të Parlamentit të këtij entiteti, Nenad Stevandiç. Ata akuzohen se kanë kryer veprën penale të "sulmit ndaj rendit kushtetues". Dodiku përsëriti qëndrimin e tij se ai nuk do t'i përgjigjet thirrjes të Prokurorisë për t'u marrë në pyetje. "Ne nuk do të përgjigjemi, le të shohim se çfarë do të bëjnë ata", tha ai gjatë konferencës ku folën edhe Vishkoviç dhe Stevandiç. Ligji për Procedurën Penale i Bosnjë-Hercegovinës parashikon

mundësinë e lëshimit të urdhrit për sjellje të detyruar për dhënien e dëshmisë, në rast se personi i thirrur në institucionet gjyqësore refuzon ta bëjë këtë. Kur u pyet çfarë do të ndodhte nëse lëshohet një urdhër për arrestimin e tij, ai nuk dha një përgjigje specifike, por i akuzoi gazetarët se nuk i dinë procedurat. Dodiku u pyet nëse EUFOR-i do të përfshihet në këtë proces dhe ai u përgjigj se kjo ishte "pyetje idiote" pasi EUFOR-i nuk ka mandat për një gjë të tillë. Gjatë bisedës me gazetarë, Dodiku, po ashtu, njoftoi se shumë shpejt do të zhvillojë një takim të nivelit të lartë në Rusi, ku do të kërkojë nga Moska që të vendosë veto ndaj pranisë së EUFOR-it në Bosnjë. Ai tha se nuk ka nevojë për shqetësim, duke thënë se "është një goditje që jam i gatshëm ta përballoj për RS-në". "Kjo është një



çështje e pavlerë, e motivuar politikisht, sepse nuk ka asnjë ligj që përcakton si krime veprat për të cilat po akuzohemi. Ne nuk do të marrim pjesë në këtë. Nëse dikush mendon se jemi frikacakë, e ka shumë gabim. Mesazhi im është vetëm të mos e teproni, përndryshe do të ndiqeni penalisht", tha Dodiku. Prokuroria ka lëshuar urdhër për arrestim ndaj Policisë

Gjyqësore të Gjykatës së Bosnjë-Hercegovinës, duke kërkuar ndihmën e Agjencisë Shtetërore për Hetim dhe Mbrojtje (SIPA). "Unë nuk do të rekomandoja që SIPA të veprojë dhe besoj se nuk do ta bëjë. Gjithashtu, kam besim te policia e RS-së", tha ai. Ai gjithashtu deklaroi se RS mbetet e përkushtuar ndaj ligjeve të miratuara së voni,

edhe pse ato janë shpallur antikushtetuese, dhe të cilat ndalojnë punën e Gjykatës dhe Prokurorisë së Bosnjë-Hercegovinës në territorin e këtij entiteti. Duke iu drejtuar gazetarëve në Banjallukë, Stevandiç dhe Vishkoviç deklaruan se nuk kanë ndër mend t'i përgjigjen Prokurorisë së Bosnjë-Hercegovinës. Njoftimi për lëshimin e urdhrit për ndalim vjen në ditën kur autoritetet në RS po diskutojnë që entitetin në Bosnjë-Hercegovinë ta përcaktojnë si shtet të popullit serb, t'i japin të drejtën për vetëvendosje, ta krijojnë ushtrinë e vet dhe të heqin Këshillin e Popujve, sipas një drafti të ri të Kushtetutës të Republikës Sërpska, të cilin e ka parë Radio Evropa e Lirë. Këto ndryshime bien ndesh me Kushtetutën e Bosnjë-Hercegovinës.

## Rusia dhe Ukraina kryejnë sulme ndaj njëra-tjetrës

**KRIVIJ RIH, 12 MARS** - Rusia dhe Ukraina kanë kryer sulme ajrore gjatë natës, vetëm disa orë pasi Kiev i pajtua për një armëpushim 30-ditor pas negociatave me zyrtarët amerikanë në Arabinë Saudite. Dy sulme me raketa të kryera nga Rusia goditën qytetin Krivij Rih të Ukrainës, tha guvernatori rajonal Serhiy Lysak më 12 mars. Ai tha se nga këto sulme u vra një person, ndërkaq në një sulm të ndarë ndaj një anijeje mallrash pranë qytetit të Odesës u vranë katër anëtarë të bordit të anijes. Më pas, kryeqyteti ukrainas, Kiev, u godit nga një sulm tjetër i madh. Sulmi ndodhi vetëm



disa orë pas negociatave në Xhedah të Arabisë Saudite mes delegacionit ukrainas dhe atij

amerikan lidhur me përfundimin e luftës që Rusia nisi kundër Ukrainës më 2022.

Kryetari i Kievit, Vitali Klitschko, tha se mbrojtja ajrore u aktivizua dhe zbrapsi sulmet. Sulme janë raportuar edhe në Harkiv dhe Ministria për Transformim Digjital e Ukrainës tha se alarmet për sulme ajrore janë aktivizuar në dhjetë rajone që gjenden përreth Kievit. Ministria ruse e Mbrojtjes tha se sistemet e saj kundërajrore kanë rrëzuar gjashtë dronë gjatë natës, një mbi Krimenë e aneksuar nga Moska dhe pesë mbi Detin e Zi. Kanali në "Telegram", "The Krymsky Veter", raportoi për shpërthime të fuqishme dhe lëshim të alarmeve paralajmëruese për


sulme në qytetet në Gadishullin ukrainas të Krimës dhe pranë objekteve të ushtrisë ruse. Rusia, ndërkaq, tha se ka bërë përpamime të tjera në rajonin perëndimor të Kurskut, teksa Moska po tenton t'i dëbojë forcat ruse që kanë pushtuar disa pjesë të territorit rus që nga gushti i vitit të kaluar. Sulmet u kryen pasi Ukraina shprehu gatishmëri për ta pranuar propozimin amerikan për zbatimin e një marrëveshje të përkohshme armëpushimi, me kohëzgjatje për 30 ditë, teksa ShBA-ja ka thënë se tani është në dorën e Moskës që të pajtohet në mënyrë që të hyjë në fuqi armëpushimi.

## ShBA-ja rrit tarifën ndaj importeve të çelikut dhe aluminit, BE përgjigjet me kundërmasa

**WASHINGTON, 12 MARS** - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, zyrtarisht ka rritur tarifën ndaj të gjitha importeve të çelikut dhe aluminit në 25 për qind më 12 mars, duke premtuar se tarifa do të ndihmojë krijimin e vendeve të punës në fabrikat në ShBA, në një kohë kur kërcënimet e tij me tarifa kanë tronditur tregun global. Bashkimi Evropian tha se do të përgjigjet ndaj hyrjes në fuqi të tarifave amerikane me kundërmasa. Trumpi hoqi të gjitha përjashtimet e bëra nga tarifën e vendosura nga ai më 2018 ndaj

metaleve, duke rritur tarifën për aluminit nga 10 në 25 për qind. Ndaras Trumpi ka vendosur tarifën të veçanta ndaj Kanadasë, Meksikës dhe Kinës dhe, po ashtu, ka thënë se ka në plan të vendosë tarifën ndaj importeve nga Bashkimi Evropian, Brazili dhe Koreja e Jugut me qëllim që të vendosë taksa "reciproke" që do të hyjnë në fuqi më 2 prill. Trumpi u tha udhëheqësve të biznesit gjatë një tryeze diskutimi të martën se tarifën po bëjnë që kompanitë të investojnë në fabrikat amerikane. Po të martën Trumpi kërcënoi se do të vendosë tarifën prej 50-

përqindësh ndaj çelikut dhe aluminit nga Kanadaja, por vendosi që kjo masë të jetë në 25 për qind pasi provinca e Ontarios hoqi dorë nga plani për të vendosur një tarifë shtesë ndaj energjisë elektrike që shet në Miçigan, Minesota dhe Nju-Jork. BE-ja, ndërkaq, më 12 mars njoftoi për kundërmasa që tha se do të hyjnë në fuqi më 1 prill, pas njoftimit të Trumpit për tarifën prej 25-përqindësh ndaj të gjitha importeve të çelikut dhe aluminit. "Tëksa ShBA-ja po vendosë tarifën në vlerë prej 28 miliardë dollarësh, ne po përgjigjemi me kundërmasa në



vlerë prej 26 miliardë eurosh [28 miliardë dollarë]", tha presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen,

përmes një deklaratë. KE-ja menaxhon konfliktet tregtare dhe komerciale në emër të 27 vendeve anëtare të BE-së.

## Miratohet nisma për shkëmbim të informacionit të klasifikuar në mes të Kosovës dhe Sllovenisë

PRISHTINË, 12 MARS - Qeveria e Kosovës ka miratuar shqyrtimin e nismës për lidhjen e Marrëveshjes së Përgjithshme të Sigurisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Sllovenisë për Shkëmbim dhe Mbrojtje të Ndërsjellë të Informacionit të Klasifikuar. Në mbledhjen e qeverisë, kryeministri Albin Kurti tha se ky është një hap i rëndësishëm

me ndikim në disa aspekte si në forcimin e bashkëpunimit dypalësh, sigurimin e informacioneve të klasifikuara, përmirësimin e kapaciteteve institucionale dhe mbështetjen për integrim euroatlantik. “Në përputhje me prioritetet strategjike të Republikës së Kosovës për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe përmbushjes së standardeve të


sigurisë në nivel evropian e më gjerë, Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar (AMIK) në kuadër të mandatit të saj ligjor ka vendosur që në marrëdhënie me autoritetet homologe, me theks të veçantë nga vendet anëtare BE-së dhe të NATO-s. Në dritën e saj AMIK ka ndërmarrë veprimet e nevojshme në funksion të vendosjes së kontakteve me NSA-n nga shteti i Sllovenisë,

ku për rrjedhojë arrihet harmonizimi i vullnetit dhe gatishmëria nga të dyja palët për ta avancuar tutje arritjen e marrëveshjes së përgjithshme të sigurisë. Arritja e marrëveshjes së sigurisë në fushën e mbrojtjes dhe informacionit të klasifikuar mes Kosovës dhe Sllovenisë është hap i rëndësishëm me ndikim në disa aspekte, forcimi, bashkëpunimi



dypalësh, sigurimi i informacioneve të klasifikuara, përmirësimi i kapaciteteve institucionale dhe mbështetja për integrim euroatlantik”, ka thënë Kurti.

## PËRFUNDON RINUMËRIMI I 50 VENDVOTIMEVE NË QNR



PRISHTINË, 12 MARS - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka njoftuar se në Qendrën për Numërim dhe Rezultate ka përfunduar rinumërimi i 50 vendvotimeve të zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit. KQZ-ja mori vendim më herët gjatë javës që 15 nga këto vendvotime të rinumëroheshin për shkak të mospërputhjeve të numrit të nënshkrimeve në listën e votuesve me numrin e fletëvotimeve brenda në kutitë e votimit të këtyre vendvotimeve. Ndërkaq, 25 kutitë e tjera i përkisnin komunës së Vushtrrisë pasi kishte

“mospërputhje të rezultateve” të kandidatëve për deputetë. KQZ-ja mesditën e së mërkurës ka nisur rinumërimin e fletëvotimeve të pavlefshme nga votimi me postë. Më 5 shkurt KQZ-ja kishte njoftuar për përfundimin e numërimit të të gjitha votave për zgjedhjet e rregullta parlamentare të 9 shkurtit. Pas kësaj, partitë dhe kandidatët kishin mundësi të dërgonin ankesa në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia. Pasi të ketë përfunduar procesi i rinumërimit të votave me postë, KQZ-ja

mund ta certifikojë rezultatin zgjedhor dhe t'i hapë rrugë formimit të institucioneve të reja të Kosovës. Lëvizja Vetëvendosje e kryeministrit Albin Kurti është fituese e zgjedhjeve, por ajo ka fituar 48 ulëse në Kuvend, të pamjaftueshme për të krijuar vetë ekzekutivin e ri. LV-ja ka thënë se ka pak gjasa për bashkëpunim me partitë opozitare dhe ka shprehur dëshirën që qeverinë ta formojë me partitë joserbe. Edhe partitë opozitare shqiptare janë shprehur kundër bashkëpunimit me partinë e Kurtit.

## ÇEKU I REAGON ABDIXHIKUT: SI MUND TË BËHESH KRYEMINISTËR NË NJË PALË ZGJEDHJE QË I KE HUMBUR

PRISHTINË, 12 MARS - Ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku nga Vetëvendosja, i ka reaguar kreut të LDK-së, Lumir Abdixhiku, për deklaratën e tij se pa pozitën e kryeministrit nuk hyjnë në koalicion me partitë opozitare, madje e ka përjashtuar edhe një koalicion të mundshëm me partinë fituese, Vetëvendosjen. Çeku thotë se kjo deklaratë e Abdixhikut është në kundërtënie me deklaratën e tij të dhënë disa ditë pas zgjedhjeve. “Është mirë që z. Abdixhiku të na tregojë për cilat fjalë ta mbajmë. Më 12 shkurt shkroi në Facebook se

‘LDK nuk i ka fituar zgjedhjet...’ dhe se ‘...ky rezultat nuk është rezultat ndryshimi për Kosovën, sepse populli i Kosovës ka tjera preferenca. I respektojmë’. Tash, paska thënë që, nëse ia japin postin e Kryeministrit, atëherë e rrëmben pushtetin. Cilin Lumir të mbajmë për fjalë? Atë që thotë se LDK s’ka fituar dhe se ky nuk është rezultat ndryshimi, apo Lumirin tjetër, i cili thotë që s’ka rëndësi fituesi dhe preferenca e qytetarit? Po tash, si mund të bëhesh kryeministër në një palë zgjedhje që i ke humbur, e ku fituesi është afër trefish larg

teje? Kjo i bie të bëhesh kryeministër me çdo kusht”, shkroi ai. Çeku tha se “ky është standardi i mashtrimit që e kemi parë në të kaluarën”, ndërsa hodhi akuza ndaj tij për votat e ardhura me postë. “Deri tash, të vetmet fjalë që i ka mbajtur janë ato për sa vota janë në kutitë e votimit me postë. Aty e ka ditur ende pa filluar numërimi”. Para disa ditësh Abdixhiku ka thënë se për LDK-në opSION mund të jetë koalicioni me partitë opozitare vetëm nëse i ofrohet pozita e kryeministrit dhe nëse arrihet marrëveshje për pozitën e presidentit.



## Edita Tahiri: Kurti po pretendon ta dështojë tutje Kosovën duke insistuar që të bëhet sërish kryeministër

PRISHTINË, 12 MARS - Ish-kryenegociatorja e Kosovës për bisedimet me Serbinë, Edita Tahiri, ka folur për vizitën që bëri dje në Kosovë sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte. Tahiri në “Facebook” ka shkruar se vizita e Ruttes e la Kosovën në sanksione dhe se mbeti veç fjalë kërkesa që Serbia të

japë llogari për sulmin e 24 shtatorit 2023 në Banjskë. Ajo thotë se dështimet e qeverisë Kurti po i pëson shteti ynë, ndërsa Kurti po tenton ta dështojë sërish, sipas saj, “duke insistuar të bëhet kryeministër”. “Vizita e sekretarit të NATO-s e la Kosovën në sanksione, ndërsa mbeti veç në fjalë

kërkesa që Serbia duhet të jap llogari për sulmin në Banjskë - dështimet e qeverisë Kurti po i pëson Kosova tutje, ndërsa Kurti po pretendon ta dështoj tutje Kosovën duke insistuar që të bëhet prapë kryeministër. Çfarë mjerimi i një pushtetari”, ka shkruar Tahiri.





# QEVERIA, ENDE E PAARRITSHME

Zgjedhjet në Kosovë mund të kenë përfunduar, por koha kur vendi do të ketë qeveri të re duket se është ende larg. Me partitë opozitare që e përjashtojnë bashkëpunimin me Vetëvendosjen dhe me këtë të fundit që këmbëngul se do ta formojë vetë qeverinë, situata mbetet e hapur për çdo skenar

PRISHTINË, 12 MARS - Me votat që nuk i mundësojnë qeverisjen e vetme, Lëvizja Vetëvendosje e Albin Kurtit këmbëngul se do ta formojë qeverinë e re të Kosovës. Se me kë nuk është ende e qartë. Partitë aktualisht në opozitë mbeten kategorikisht kundër bashkëpunimit me partinë aktualisht në pushtet. "Me Vetëvendosjen nuk shohim pika takimi", përsëriti kandidati për kryeministër nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, në "Klan Kosova" më 10 mars. "Nuk duam dhe nuk punojmë për bashkëpunim me të [LV-në]. Ky ka qenë qëndrimi ynë paraelektoral dhe mbetet i njëjtë", tha kandidati

për kryeministër i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, në një konferencë për medie, po më 10 mars. LDK-ja, sipas tij, do ta konsideronte si opsion koalicionin me partitë e tjera vetëm nëse do t'i ofrohej pozita e kryeministrit dhe do të arrihej marrëveshje për pozitën e presidentit - mandati i të cilit kalon në vitin e ardhshëm. Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës thonë se Qeveria e re e Kosovës duhet të formohet nga partitë opozitare. "Ne angazhohemi që opozita ta formojë qeverinë e re", thotë për Radion Evropa e Lirë Ahmet Isufi, anëtar i Kryesisë së AAK-së. "Kosova duhet t'i kthehet

trendit të zhvillimit të brendshëm dhe riparimit të marrëdhënieve me jashtë", shton ai. Në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, partia e tij ka garuar në koalicion me partinë Nisma të Fatmir Limajt, i cili është i vetmi nga opozita që ka thënë se nuk ka "vija të kuqe" sa iu përket koalicioneve të mundshme, qoftë me Vetëvendosjen apo me partitë e tjera opozitare. Pavarësisht prej kësaj, Isufi këmbëngul se partia e tij nuk ka ndonjë "mospërputhje të madhe" me Nismën e Limajt. "Kemi kontakte normale. Presim certifikimin e rezultateve, që pastaj të bashkëpunojmë për një qeveri që do t'i përmbledhë partitë opozitare", thotë Isufi. Se kur do të bëhet certifikimi i rezultateve nuk është e qartë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka përmendur më herët mesin e marsit, ndërkohë ka pasur edhe kërkesa për përsëritjen e votimit përmes postës, por ato janë refuzuar nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. Ashtu siç qëndrojnë rezultatet tash për tash, asnjëra parti nuk

ka vota të mjaftueshme për ta formuar e vetme qeverinë. Lëvizja Vetëvendosje ka siguruar 48 mandate në Kuvendin e Kosovës, PDK-ja 24, LDK-ja 20, AAK-Nisma 8, Lista Serbe 9, Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë 1 dhe komunitetet joserbe 10. E për formimin e qeverisë duhen së paku 61 deputetë.

## Si e shohin analistët situatën?

Naim Rashiti, drejtor i Grupit Ballkanik për Politika në Prishtinë, thotë se tash për tash nuk mund të thuhet se kush mund ta formojë qeverinë - Vetëvendosje apo partitë opozitare. "Është e vështirë, por përgjegjësia kryesore bie mbi fituesin e zgjedhjeve. I tërë procesi, barra e procesit për formimin e qeverisë, i bie Lëvizjes Vetëvendosje - qoftë vetëm, qoftë me kompromise programore në raport me subjektet e tjera", thotë Rashiti për Radion Evropa e Lirë. Sipas tij, në rast se Lëvizja Vetëvendosje dështon, atëherë përgjegjësia u kalon partive

opozitare. Nënkryetari i Vetëvendosjes, Glauk Konjufca, ka thënë se partia e tij planifikon ta formojë qeverinë me ndihmën e votave të komuniteteve pakicë joserbe. Përfaqësuesit e këtyre të fundit kanë thënë se, parimisht, do të mbështesnin cilindo mandatar për formimin e qeverisë së re, por edhe 10 mandatet e tyre parlamentare janë të pamjaftueshme për Vetëvendosjen që ta arrijë numrin prej 61 deputetësh. Në këtë situatë të paqartë, e ardhmja e Qeverisë së re të Kosovës duket se do të varet nga kompromiset politike në ditët apo javët në vijim. Për certifikimin e rezultatit të zgjedhjeve nga KQZ-ja nuk ka ndonjë afat ligjor. Por, 30 ditë pas certifikimit të tyre, presidentja e vendit, Vjosa Osmani duhet ta thërrasë mbledhjen konstituive të Kuvendit të Kosovës. Konstituimi përfundon me zgjedhjen e kryetarit dhe nënkryetarëve të tij. Kjo praktikë edhe mund të zgjasë - në vitin 2014 janë dashur rreth gjashtë muaj.

## Ushtarët e KFOR-it përfundojnë marshin norvegjez të këmbësorisë në kompleksin Bondsteel

PRISHTINË, 12 MARS - Ushtarë nga vende të ndryshme, të caktuar në Komandën Rajonale Lindje të misionit të udhëhequr nga NATO, KFOR, e kanë përfunduar me sukses Marshin Norvegjez të Këmbësorisë në Kampin Bondsteel, Kosovë. Gjatë këtij testi sfidues të qëndrueshmërisë, pjesëmarrësit marshuan 30 kilometra me një çantë 11-kilogramëshe, duke e përfunduar sfidën brenda kohës së përcaktuar sipas

grupmoshës dhe gjinisë. Ky marsh u mbajt për herë të parë në vitin 1915 si një test për qëndrueshmërinë e ushtarëve të Ushtrisë Norvegjeze, me qëllim që trupat të ishin në gjendje luftarake edhe pas një distance të madhe. Me kalimin e kohës ai është shndërruar në një simbol nderi për pjesëtarët e forcave të huaja, duke u bërë një nga medaljet më të vlerësuara të shërbimit ndërkombëtar, thuhet në postimin e NATO-s

në "Facebook". KFOR-i vazhdon ta zbatojë mandatin sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, duke kontribuar në një mjedis të sigurt për të gjitha komunitetet në Kosovë dhe duke siguruar lirinë e lëvizjes. Ky mision bashkëpunon ngushtë me Policinë e Kosovës dhe misionin e BE-së për sundimin e ligjit, EULEX, për të garantuar stabilitet dhe siguri në rajon.



# NATO RIAFIRMON ANGAZHIMIN PËR STABILITETIN NË BALLKANIN PERËNDIMOR

PRISHTINË, 12 MARS - NATO ka riafirmuar angazhimin e saj për stabilitetin e Ballkanit Perëndimor, ndërsa sekretari i përgjithshëm, Mark Rutte, ka përfunduar vizitën në Sarajevë dhe në Prishtinë. Kështu u bë me dije në njoftimin për medie nga zyra e KFOR-it ku, ndër të tjera, thuhet se më 10 dhe 11 mars 2025, sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, vizitoi Sarajevën dhe Prishtinën.

Sipas njoftimit, në Sarajevë ai u takua me zyrtarë të nivelit të lartë nga Bosnjë-Hercegovina, si dhe u angazhua edhe me studentët në Universitetin e Sarajevës.

Gjatë vizitës së tij Rutte theksoi se "NATO mbetet fuqishëm e përkushtuar ndaj stabilitetit të këtij rajoni dhe ndaj sovranitetit, integritetit territorial dhe sigurisë së Bosnjë-Hercegovinës".

Ai tha: "Marrëveshja e Paqes së Dejtonit është gur themeli i paqes në këtë vend dhe duhet respektuar dhe ne embështesim zyrën e Përfaqësuesit të Lartë. Çdo veprim që cenon Dejtonin, rendin kushtetues ose institucionet kombëtare, është i papranueshëm. Retorika dhe veprimet inflamatorë janë të rrezikshme; ato përbëjnë një kërcënim të drejtpërdrejtë për stabilitetin dhe sigurinë e Bosnjë-Hercegovinës".

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s nënvizoi nevojën që liderët politikë në Bosnjë-Hercegovinë "ta bëjnë pjesën e

tyre" dhe "të marrin përgjegjësi" për përparimin dhe stabilitetin e vendit të tyre.

Ai e bëri të qartë se "ky nuk është viti 1992" dhe se NATO dhe partnerët e saj ndërkombëtarë janë të pranishëm dhe të angazhuar në Bosnjë-Hercegovinë dhe "nuk do të lejojnë të shfaqet një vakum sigurie".

Në fund, ai theksoi se Aleanca qëndron e përkushtuar në bashkëpunimin e saj me Bosnjë-Hercegovinën.

"Ne tashmë kemi një partneritet solid dhe jemi të përgatitur ta ndërtojmë mbështetjen e gjatë të NATO-s për një Forcë të Armatosur të unifikuar të BiH-së dhe për reformat e mbrojtjes dhe sigurisë, nëpërmjet selisë në Sarajevë, celulës politike të sapokrijuar dhe paketës të ndërtimit të kapaciteteve mbrojtëse", tha ai.

Po në Prishtinë, sekretari i përgjithshëm udhëhoqi një vizitë të Këshillit të Atlantikut të Veriut dhe partnerëve kontribuues të trupave në misionin e KFOR-it të udhëhequr nga NATO dhe Ekipin Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s.

Së bashku me zëvendëssekretaren e përgjithshme të NATO-s, Radmila Shekerinska dhe kryesuesin e Komitetit Usharak të NATO-s, admiralin Giuseppe Cavo Dragone, ata u takuan me udhëheqjen dhe personelin e KFOR-it dhe Ekipin Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT).



Ata kanë shkëmbyer mendime edhe me shefat e misioneve të Bashkimit Evropian, Misionin e BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së dhe Shefit e Misionit të UNMIK-ut, si dhe Ushtruesin e Detyrës së Shefit të Misionit të OSBE-së.

Më tej, sekretari i përgjithshëm u takua me përfaqësues të institucioneve në Kosovë për diskutime bilaterale. "NATO ka mbështetur paqen dhe stabilitetin në rajonin e Ballkanit Perëndimor për tridhjetë vjet. Angazhimi ynë mbetet i fortë edhe sot, i kryesuar nga KFOR-i, i cili është misioni ynë më i gjatë dhe aktualisht më i madh. Nën udhëheqjen e shkëlqyer të

gjeneralmajor Enrico Barduani, trupat tona të KFOR-it punojnë pa pushim për të siguruar një mjedis të sigurt për të gjithë njerëzit dhe komunitetet që jetojnë në Kosovë në përputhje me mandatin e gjatë të KFOR-it në OKB; dhe Ekipi Këshillues dhe Ndërlidhës i NATO-s vazhdon t'i mbështesë organizatat e sigurisë në Kosovë përmes ngritjes së kapaciteteve, edukimit dhe koordinimit të trajnimit; një rajon i sigurt i Ballkanit Perëndimor do të thotë më shumë siguri në të gjithë zonën euroatlantike", tha sekretari i përgjithshëm Rutte, duke shtuar se NATO-ja do të vazhdojë ta luajë rolin e saj në koordinim të ngushtë me Policinë e Kosovës dhe Misionin e BE-së për Sundimin

e Ligjit në Kosovë. "Në rolet tona përkatëse si reagues të sigurisë. Zgjidhja që çon drejt paqes afatgjatë është politike; NATO do të vazhdojë ta mbështesë plotësisht normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, të udhëhequr nga Bashkimi Evropian; kjo është mënyra e vetme për t'i zgjidhur çështjet në pritje dhe për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme, duke siguruar që të drejtat e të gjitha komuniteteve të respektohen dhe të mbrohen; për ta çuar përpara dialogun, të dyja palët duhet të tregojnë fleksibilitet, t'i bëjnë kompromiset e nevojshme dhe të fokusohen në përfitimet afatgjatë", theksoi Rutte.

# MSA, SHASHA: KOSOVA QË NGA VITI 2016 NUK KA BËRË ASNJË PËRPARIM NË RRUGËN INTEGRUESE

PRISHTINË, 12 MARS - "Nga viti 2016 Kosova nuk ka bërë asnjë përparim në rrugën integruese. Që nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), Kosova nuk ka bërë asnjë përparim". Kështu u theksua në Barometrën e Reformave Evropiane 2024 nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) dhe nga Instituti i Kosovës për Politika Evropiane (EPIK), në të cilën i pranishëm ishte edhe shefi i BE-së në Kosovë, Aivo Orav.

Drejtoresha ekzekutive në GLPS, Arbëresha Loxha-Stublla, ka theksuar se integrimi evropian dhe reformat e lidhura me këtë proces nuk kanë qenë prioritet i lartë në agjendën e qeverive të kaluara, me ç'rast, siç tha ajo, ka çuar në humbjen e momentit për ndryshime të rëndësishme. Ajo nënvizoi se mungesa e vullnetit politik ka ndikuar drejtpërdrejt në ngecjen e reformave, ndërkohë që



Kosova vazhdon të mbetet nën masa nga Bashkimi Evropian. Shefi i Zyrës së Bashkimit

Evropian në Kosovë, Aivo Orav theksoi se barometri është një mjet shtesë shumë i rëndësishëm në procesin e

zgjerimit. Derisa shton se për Ministrinë e Drejtësisë, "në fushën e sundimit të ligjit, është e nevojshme që

gjyqësori dhe prokuroria të bëjnë më shumë përpjekje për të hetuar dhe gjykuar në mënyrë efektive rastet e krimin të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë". Ndërkaq drejtori ekzekutiv i organizatës EPIK, Demush Shasha, ka thënë se nga viti 2016 Kosova nuk ka bërë asnjë përparim në rrugën integruese. "Mund të thuhet se që nga viti 2016 Kosova nuk ka bërë asnjë përparim në rrugën integruese. Që nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Kosova nuk ka bërë asnjë përparim tutje. E spostojmë për momentin liberalizmin e vizave për shkak se ajo del jashtë procesit integrues. Në këtë sfond ne kemi dashur përmes barometrit ta kthejmë vëmendje te procesi integrues", tha ai.

Më 1 prill të vitit 2016 ka hyrë në fuqi Marrëveshja e Stabilizim Asociimit në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

## Deda: Me këtë qasje të partive politike, më mirë të shkojmë në zgjedhje të reja

PRISHTINË, 12 MARS - Opinionisti Ilir Deda vlerëson se nëse vazhdohet me qasjen e njëjtë të partive politike lidhur me koalicionet dhe krijimin e qeverisë, më së miri do të ishte të shkohet në zgjedhje të reja. Siç u shpreh në emisionin 'Rubikon' në 'Klan Kosova', interesat e partive politike janë të parëndësishme.

"Interesi i Republikës së

Kosovës është që Kosova ta ketë një qeveri stabile, e cila i përmirëson marrëdhëniet me ShBA-në, e cila i heq sanksionet e BE-së, e cila i merr obligimet me të cilat Kosova rritet politikisht, bëhet pjesë e stabilitetit të Ballkanit perëndimor dhe rreshtohet me të dy boshtet perëndimorë. Interesat e partive politike janë të

parëndësishme. Askujt nuk ia ndien në këtë furtunë gjeopolitike se cilat janë interesat e disa partive në Republikën e Kosovës. Nëse me të vërtetë kështu kanë për të vazhduar, unë besoj që më së miri është të shkohet me zgjedhje të reja", ka deklaruar Deda, duke shtuar se "e kemi një Kuvend ku askush s'mund ta mbërrijë shumicën".



## KOSOVA MIRATON TRI MARRËVESHJE ME BRITANINË E MADHE DHE IRLANDËN E VERIUT

PRISHTINË, 12 MARS - Tri marrëveshje në fushën e drejtësisë janë miratuar të mërkurën në mbledhjen e qeverisë në mes të Kosovës, Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut.

Kryeministri Albin Kurti gjatë kësaj mbledhjeje tha se këto marrëveshje do ta forcojnë më tej bashkëpunimin në fushën e drejtësisë. "Republika e Kosovës ka vazhduar ta avancojë pozicionin e saj në marrëdhëniet me shtetet e ndryshme. Në këtë kuadër, Mbretëria e Bashkuar ka pranuar ta thellojë bashkëpunimin për transferimin e personave të



dënuar, ndihmën e ndërsjellë juridike në çështje penale dhe ekstradimet ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar", tha

Kurti para kabinetit qeveritar. Ndërkohë ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, paraqiti të tri marrëveshjet. Marrëveshja e parë e paraqitur

nga Haxhiu është ajo për transferimin e personave të dënuar ndërmjet Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës së Veriut. "Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është përmirësimi i mëtejshëm i bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën e drejtësisë, vendosja e drejtësisë dhe rehabilitimi social i personave të dënuar, duke mundësuar ekzekutimin e sanksioneve penale në shtetin e vendbanimit të përhershëm të personit të dënuar", tha Haxhiu.

Marrëveshja e dytë lidhet me ndihmën e ndërsjellë juridike

në çështje penale ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut. "Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit në fushën e ndihmës juridike në çështjet penale", u shpreh Haxhiu. Marrëveshja e tretë është ajo për ekstradim ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar, përfshirë Irlandën e Veriut. "Kjo marrëveshje bazohet në aspiratën dhe zotimin e Republikës së Kosovës për ta zhvilluar partneritetin evropian".

## ADMIRALI DRAGONE: KFOR-i VAZHDON TA RUAJË PAQEN DHE STABILITETIN NË KOSOVË



PRISHTINË, 12 MARS - KFOR-i siguron një mjedis të sigurt duke nxitur një Kosovë shumetnike dhe demokratike, tha admirali Giuseppe Cavo Dragone, i cili qëndroi në Prishtinë bashkë me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte.

Giuseppe Cavo Dragone, i cili është kryesues i Komitetit Usharak të NATO-s, e lavdëroi "përkushtimin e palëkundur të të gjithë personelit të KFOR-it, i cili vazhdon ta ruajë paqen dhe stabilitetin në Kosovë që nga

viti 1999". "Vlerësim i veçantë për Ekipin Ndërlidhës dhe Këshillues të NATO-s, tani i udhëhequr nga gjenerali Christian Nawrat, për rolin e tyre kryesor në këshillimin dhe mbështetjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, duke rritur stabilitetin rajonal", ka shkruar në "X" admirali Giuseppe Cavo Dragone.

Gjatë vizitës së tij në Prishtinë më 11 mars, Mark Rutte tha se NATO-ja mbështet paqen dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor, raporton

"KosovaPress". "Prania sot këtu është një demonstrim i qartë i përkushtimit për siguri afatgjatë në Kosovë. NATO ka mbështetur paqen dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor. Ekipet e ndërlidhjes së KFOR-it vazhdojnë t'i mbështesin institucionet e tjera të sigurisë. Një rajon më i sigurt nënkupton më shumë siguri për zonën e NATO-s. NATO do të vazhdojë ta luajë rolin e vet në bashkërendim me policinë dhe EULEX-in", tha ai.

## Inspektorati i Trashëgimisë Kulturore ndalon punimet në sheshin "Xhorxh Bush" në kryeqytet

PRISHTINË, 12 MARS - Inspektorati i Trashëgimisë Kulturore ka ndaluar punimet e nisura të hënën në sheshin "Xhorxh Bush" në kryeqytet. Gjatë së mërkurës, pllakatit të projektit i është vendosur njoftimi për ndalim të punimeve, i cili nënkupton ndalimin e punimeve derisa komuna ta çojë projektin në Institutin e Kosovës për Mbrojtje të Monumenteve dhe ta marrë miratimin për këtë projekt, e tek atëherë mund ta nisë punën në mbikëqyrjen e institucioneve

të trashëgimisë kulturore. Të hënën kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka përruar nisjen e punimeve pa e marrë pëlqimin nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve. Punimet në këtë bulevard zhvillohen midis monumenteve "Grand Hotel"-it, Rektoratit të Universitetit të Prishtinës, Radios-Kosova dhe Bibliotekës Kombëtare të Kosovës. Ligji për Trashëgiminë Kulturore, i

miratuar qysh më 2006, përcakton se për çdo intervenim në pronat e trashëgimisë kulturore ose ato afër tyre kërkohet pëlqim ose leje nga institucioni kompetent. Në këtë rast institucion kompetent është Instituti i Kosovës për Trashëgimi Kulturore. Projekti për të cilin është kontraktuar kompania nga Shqipëria "Salillari" dhe disa kontraktues të tjerë nga Kosova ka peshë financiare prej 18 milionë e 400 mijë eurosh.



## Komandanti i Ushtrisë Amerikane për Evropë dhe Afrikë konfirmon mbështetjen për FSK-në

PRISHTINË, 12 MARS - Komandanti i Ushtrisë Amerikane për Evropë dhe Afrikë (U.S. Army Europe and Africa), gjeneral Christopher Donahue, ka vizituar Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ai është pritur në takim nga komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (KOMFSK), gjeneralleteniant Bashkim Jashari. Fillimisht gjeneral Jashari e njoftoi gjeneralin Donahue mbi të arriturat e FSK-së, situatën aktuale dhe

planifikimet për të ardhmen. Pastaj gjatë takimit u diskutua në përgjithësi mbi sfidat globale të sigurisë, në veçanti mbi sfidat rajonale. Ndërsa gjeneral Donahue e përgëzoi gjeneral Jasharin për lidhshirësinë e treguar gjatë proceseve dhe sfidave të ndryshme në të cilat ka kaluar Republika e Kosovës në përgjithësi dhe Forca e Sigurisë së Kosovës në veçanti. Gjithashtu, gjeneral Donahue konfirmoi mbështetjen për rrugëtimin e përbashkët drejt

arritjes së objektivave strategjike. Në fund të dy gjeneralët diskutuan për investimet në projektet e përbashkëta me interes reciprok të ushtrisë amerikane dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës të cilat ndikojnë në rritjen e sigurisë rajonale dhe më gjerë. Ky takim konfirmon edhe një herë partneritetin e fuqishëm ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.



## Antidroga e Policisë së Kosovës realizon operacionin 'Befasia'

*Sekuestrohen lëndë narkotike dhe arrestohet i dyshuari për trafikim të substancave narkotike*

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 12 MARS - Më 11 mars 2025 Policia e Kosovës, konkretisht hetuesit e Drejtorisë për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve - Mitrovicë Jug, në bashkëpunim me Njësinë e Reagimit të Shpejtë - Mitrovicë Jug, kanë realizuar një kontroll të planifikuar në një shtëpi dhe objektet përcjellëse në lagjen Koloni në qytetin e Mitrovicës. Ky kontroll është realizuar si pjesë e planit taktik të quajtur 'Befasia', në kuadër të luftës kundër krimeve të organizuara dhe trafikimit të substancave narkotike. Gjatë kontrollit të realizuar në këtë operacion policor janë sekuestruar: 24 qese me substancë të dyshuar narkotike e llojit kokaine, me



peshë totale 7.5 gramë, 6 qese me substancë narkotike të llojit marijuanë, me peshë totale 68.7 gramë, 4 tableta Ekstazi, me peshë totale 2.2 gramë, qese të zbrazëta, që shërbejnë për paketimin e substancave narkotike në sasi të vogla, 1 telefon mobil që

dyshohet të jetë përdorur për aktivitetet e paligjshme. Në vendin e ngjarjes ka dalë një ekip i krimteknikës rajonale, i cili ka kryer fotografimin, evidentimin, matjen dhe sekuestrimin e të gjitha provave materiale. Hetuesit e DHTN-së, pas

realizimit të veprimeve operative, kanë arrestuar të dyshuarin, i cili është intervistuar në prani të avokatit mbrojtës. Në bazë të urdhrat të arrestit të lëshuar nga Gjykata Themelore e Mitrovicës, i dyshuari ka një dënim të formës së prerë prej dy vitesh burgim për veprën penale "Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge", nga neni 267 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Lidhur me këtë rast është informuar Prokurori Kujdestar pranë Prokurorisë Themelore të Mitrovicës - Departamenti i Krimeve të Rënda, i cili ka urdhëruar që i dyshuari pas intervistimit të dërgohet në vuajtje të dënimit. Rasti është duke u hetuar nga Drejtorja

për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve - Mitrovicë Jug. Pas intervistimit, i dyshuari është dorëzuar në Stacionin Policor Mitrovica Jug, ku është dërguar për ta vuajtur dënimin në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë. Ky aksion është një tjetër hap në luftën e vazhdueshme kundër krimeve të organizuara dhe trafikimit të narkotikëve, dhe dëshmon angazhimin e institucioneve të rendit dhe sigurisë për mbrojtjen e qytetarëve dhe parandalimin e aktiviteteve kriminale. Policia e Kosovës mbetet e angazhuar ta vazhdojë punën për ta zbuluar dhe parandaluar çdo aktivitet kriminal që kërcënon sigurinë dhe rendin publik, në veçanti aktivitetet e tilla kriminale që rrezikojnë shëndetin e rinisë sonë.

## Kosova miraton nismën për një marrëveshje në fushën e mbrojtjes me ShBA-në

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 MARS - Qeveria e Kosovës ka miratuar në parim nismën për lidhjen e një marrëveshjeje kornizë për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes në mes të Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara. Në mbledhjen e qeverisë, kryeministri Albin Kurti, tha se me këtë marrëveshje Kosova dhe ShBA-ja angazhohen për avancimin e bashkëpunimit "në fushën e mbrojtjes si: planifikim i mbrojtjes, qëndrueshmëri strategjike si dhe ngritja e kapaciteteve strategjike ushtarake".

Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, tha se kjo nismë është në përputhje me qëllimet e Kosovës për integrim më të madh euroatlantik. "Një hap i tillë i bashkëpunimit është ndërmarrë në përputhje me qëllimet e integritimit më të gjerë euroatlantik, thellimit të kërcënimeve për sigurinë, rritjen e ndërveprueshmërisë, gjithmonë duke u mbështetur në partneritetin e fortë ekzistues në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë", tha Maqedonci gjatë mbledhjes së qeverisë. Ekzekutivi nuk dha hollësi të tjera lidhur me nismën për lidhjen e kësaj marrëveshjeje në mes të Ministrisë së Mbrojtjes



të Kosovës dhe Departamentit Amerikan të Mbrojtjes. Shtetet e Bashkuara kanë ofruar mbështetje të vazhdueshme

për strukturat e mbrojtjes dhe sigurisë së Kosovës, duke ofruar trajnime për pjesëtarët e strukturave të sigurisë, kanë

mbështetur transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri, por edhe kanë dhuruar pajisje të ndryshme ushtarake. Në të kaluarën Kosova ka arritur marrëveshje me ShBA-në, por edhe me shtete të tjera, për dërgimin e pjesëtarëve të FSK-së në misione paqeruajtëse jashtë vendit. Po ashtu, janarin e vitit të kaluar ShBA-ja njoftoi se Kosova kishte bërë kërkesë për blerjen e mbi 200 sistemeve kundërajrore Javelin që prodhohen në ShBA. Për shitjen e këtyre sistemeve, të cilat pritet t'i kushtojnë Kosovës 75 milionë dollarë, Uashingtoni ende nuk ka marrë vendim.

## Akreditohet atasheu ushtarak i Kosovës në Turqi

PRISHTINË, 12 MARS - Nënkolonel Meriman Suka ka pranuar kredencialet e atasheut ushtarak me të

drejtë të plotë i Republikës së Kosovës në Turqi. Kjo ngjarje shënon një çast të rëndësishëm në forcimin e

lidhjeve dypalëshe në fushën e mbrojtjes. "Shteti i Kosovës do ta vazhdojë bashkëpunimin e ngushtë me

Turqinë, ndërsa eksploron projekte të reja ushtarake për të ardhmen", ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes.



# Liberalizimi i tregut të energjisë: Bizneset përballen me rritje të kostos

Duke filluar nga 1 qershori, kompanitë e mëdha në Kosovë duhet t'i zgjedhin vetë furnizuesit e tyre me energji elektrike. Derisa rregullatorët e cilësojnë këtë si hap drejt liberalizimit të tregut të energjisë, drejtuesit e bizneseve paralajmërojnë për rritje të kostove dhe paqëndrueshmëri ekonomike

PRISHTINË, 12 MARS - Me kërkesë të Zyrës së Rregullatorit për Energji në Kosovë (ZRRE), të gjitha kompanitë me mbi 50 punëtorë ose me qarkullim mbi 10 milionë euro do të dalin në tregun e hapur të energjisë nga 1 qershori. Si pjesë e Ligjit për Energjinë Elektrike, kjo masë nënkupton që bizneset duhet ta zgjedhin vetë furnizuesin e tyre me energji elektrike.

Përfaqësuesit e tyre por edhe afaristët paralajmërojnë se ky tranzicion mund të shkaktojë çrregullime ekonomike dhe rritje të çmimeve të produkteve. "Në momentin që neve na qesin nga furnizimi i rregullt në furnizim të parregulluar, unë besoj se rryma do të jetë mbi 70 për qind më shtrenjtë se aktualisht", thotë Alajdin Fusha, përfaqësues i kompanisë "ABI ShPK".

Kjo kompani, me bazë në Prizren, ka nën ombrellën e vet 13 kompani të ndryshme, që ofrojnë produkte ushqimore dhe shërbime të tjera dhe punëson rreth 600 punëtorë. Aktualisht ajo paguan mbi 65 mijë euro në vit për faturat e energjisë së shpenzuar. Kostoja i është përgjysmuar që nga viti 2021 për shkak të investimeve në panele diellore.


Fusha thotë se me liberalizimin e tregut të energjisë, çmimi për kilovat nuk mund të pritet nën 15 centë, nga rreth 7 centë sa paguan kompania tash për tash. Kjo, sipas tij, me doemos do të reflektojë edhe në koston e produkteve dhe shërbimeve.

## Ku mund të furnizohen kompanitë me rrymë?

Sipas ZRRE-së, konsumatorët që dalin në tregun e liberalizuar të energjisë mund të furnizohen nga çdo kompani vendore që ka licencë ose nga kompani të huaja. Operatori për Furnizim me Energji - KESCO është furnizuesi kryesor i licencuar për energji elektrike në Kosovë.

Çmimin e produkteve të tij e përcakton ZRRE-ja. Sipas ZRRE-së, në Kosovë janë të licencuara edhe 18 kompani të tjera. "Ato mund ta kryejë aktivitetin e furnizimit dhe tregtimit me shumicë të energjisë elektrike", thuhet në përgjigjen e këtij rregullatori për Radion Evropa e Lirë, por nuk specifikohet më shumë rreth tyre.

KESCO, në një njoftim të publikuar më 5 mars, bëri me dije se me kërkesë të ZRRE-së, kompanitë komerciale me mbi 50 punëtorë ose me qarkullim mbi 10 milionë euro, do të duhet të zgjedhin furnizuesin



me rrymë brenda 15 ditësh, pasi nga data 1 qershor nuk do të jenë më në listën e konsumatorëve me tarifa të rregulluara. Ato do të kalojnë në furnizim me çmime të parregulluara të cilat përcaktohen nga kërkesa dhe oferta në treg.

## "Pasoja për bizneset"

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Lulzim Rafuna, thotë se ky ndryshim në furnizim do të ketë pasoja të rënda për bizneset e mëdha të cilat janë kryesisht prodhuese. Sipas tij, çmimi i rrymës as tash nuk është i lirë. "Dhe, shtrenjtimi i radhës do të ndikojë në rritjen e çmimeve të produkteve në tregun vendor. Gjithashtu, mund ta dëmtojë edhe konkurrueshmërinë e tyre në tregun ndërkombëtar", thotë Rafuna për Radion Evropa e Lirë.

Në Kosovë bizneset aktive sipas numrit të punëtorëve ndahen në mikro, që kanë të punësuar nga 1 deri në 9 punëtorë; të vogla me nga 10 deri në 49 punëtorë; të mesme me nga 50 deri në 249 punëtorë dhe të mëdha me mbi 250 punëtorë. Numri i dy kategorive të fundit arrin në rreth 17 300, sipas OEK-ut.

Rafuna thotë se OEK-u është interesuar për kompanitë e tjera që përmend ZRRE-ja për furnizim por, sipas tij, ato nuk funksionojnë si furnizuese të rregullta. "Institucionet nuk kanë krijuar kushte për një treg të hapur dhe konkurrues. Bizneset detyrohen të dalin në

tregun e lirë, por pa pasur mundësi të negociojnë për një çmim më të lirë dhe energji më cilësore. Kjo mund të krijojë monopol nga KESCO-ja, e cila do t'i diktojë çmimet", thotë Rafuna.

Ngjashëm shprehet edhe afaristi Fusha. "Pas njoftimit të KESCO-s, jam interesuar për këtë çështje, por nuk ka kompani tjera që garantojnë ofertë të qëndrueshme. Në fund, sërish do të furnizohemi nga KESCO-ja, por me çmime shumë më të larta", sipas tij. Radio Evropa e Lirë pyeti KESCO-n se sa do të jenë çmimet për bizneset që hyjnë në tregun e liberalizuar dhe vazhdojnë të mbeten kliente të saj, por nuk mori përgjigje.

Aktualisht për konsumatorët e amvisërisë dhe ata komerciale që shpenzojnë deri në 800 kilovatë në orë brenda një muaji, çmimi i rrymës gjatë ditës është 7.79 centë për kilovat, ndërsa për ata që shpenzojnë më shumë se 800 kilovatë, pjesa mbi këtë u llogaritet me çmim prej 14.45 centësh.

## A ka alternativa?

Arben Gjukaj, ish-drejtor i Korporatës Energjetike të Kosovës, thotë se një alternativë tjetër për furnizim me energji elektrike është që vetë kompanitë të pajisen me licenca për furnizim. "Një kompani mund të aplikojë për licencë pranë ZRRE-së dhe, pasi t'i përmbushë kriteret teknike, mund të blejë energji nga tregu i brendshëm ose

jashtë vendit. Po ashtu, mund të lidhë marrëveshje me kompani që prodhojnë energji nga burimet alternative, si panelet diellore", shpjegon Gjukaj për Radion Evropa e Lirë.

Aktualisht 85 për qind e konsumit të përgjithshëm të energjisë elektrike në Kosovë varet nga prodhimi i thëngjillit në Korporatën Energjetike të Kosovës dhe rreth 20 për qind prodhohet nga burime të ripërtërishme, si: hidrocentralet, centralet me erë dhe panelet diellore. Në përqindjen e fundit hyjnë edhe disa biznese që kanë investuar në burime të tilla, për t'i ulur kostot e energjisë.

## Pse flitet tani për liberalizimin e tregut të energjisë?

Nga ZRRE-ja thonë se liberalizimi i tregut të energjisë është paraparë qysh me Ligjin për energjinë elektrike, të miratuar në vitin 2017, por zbatimi i të cilit është shtyrë për shkak të rrethanave të ndryshme. Duke shpjeguar këtë ligj, ZRRE-ja thotë se të drejtën e furnizimit me shërbime të rregulluara, "e gëzojnë të gjithë konsumatorët familjarë dhe jofamiljarë, që kanë qarkullim vjetor jo më shumë se dhjetë milionë euro, ose jo më shumë se 50 punonjës". Realizimi i këtij procesi është shtyrë deri në mars të vitit 2021, me kërkesë të përfaqësuesve të komunitetit të biznesit, të cilët,

siç kujton Rafuna, kanë kërkuar të mos realizohet pa u krijuar kushtet e duhura. Më pas, në vitin 2021, kur ka qenë edhe kulmi i pandemisë COVID-19, ZRRE-ja ka vlerësuar se nuk është koha e duhur që bizneset t'i nënshtrohen liberalizimit të tregut të energjisë, meqë shumë prej tyre ishin prekur nga kufizimet që kishte shkakuar pandemia.

Tani, katër vjet më vonë, Rafuna dhe Fusha kërkojnë nga Qeveria e Kosovës ta shtyjë sërish fillimin e këtij procesi, derisa të ketë më shumë furnizues me energji në treg dhe të krijohen mekanizma mbrojtës për kompanitë, në mënyrë që ato të mos detyrohen të paguajnë, siç shprehen, çmime të padrejta. Radio Evropa e Lirë pyeti edhe Qeverinë, edhe ZRRE-në se cilat janë gjasat që të shqyrtohet kjo kërkesë.

Deri në publikimin e këtij artikulli, Qeveria nuk u përgjigj, ndërsa ZRRE-ja theksoi se "liberalizimi i tregut energjetik është kërkesë ligjore" dhe nuk tregoi nëse mund të shqyrtohet kërkesa ose jo.

Ky institucion tha se ka licencuar kompani të mjaftueshme për furnizim me energji, ndërsa sa u përket mekanizmave mbrojtës, theksoi se do t'i monitorojë vetë marrëveshjet mes bizneseve dhe kompanive furnizuese. "ZRRE-ja mund të ndërhyjë nëse ndodhin praktika të padrejta, siç është abuzimi me pozita dominuese nga furnizuesit", thuhet në përgjigjen e rregullatorit për Radion Evropa e Lirë.



# TRUMPI PO E BËN EVROPËN PËRSËRI TË MADHE

Gideon RACHMAN

Donald Trump nuk do të fitojë kurrë Çmimin Nobel për Paqe. Por ai duhet të jetë një kandidat i fortë për Çmimin Charlemagne – i cili jepet çdo vit për personin që ka dhënë kontributin më të madh për unitetin evropian.

Presidenti amerikan ka flirtuar me Rusinë, ka minuar besimin në aleancën e NATO-s, ka kërcënuar BE-në me tarifa dhe ka forcuar të djathtën ekstreme në Evropë. E gjitha kjo ka pasur një efekt galvanizues mbi BE-në. Hapat themelorë drejt një uniteti më të madh evropian – që kishte ngecur për dekada – tashmë po hidhen.

Ka tre fusha kryesore për t'u vëzhguar. E para është mbrojtja evropiane; e dyta është borxhi i përbashkët evropian; e treta është riparimi i çarjes midis Mbretërisë së Bashkuar dhe BE-së.

Lëkundjet dramatike në opinionin publik evropian janë në themel të këtyre zhvillimeve. Një sondazh i javës së kaluar tregoi se 78% e britanikëve e shohin Trumpin si një kërcënim për Mbretërinë e Bashkuar. Rreth 74% e gjermanëve dhe 69% e francezëve ndajnë të njëjtin mendim. Në një tjetër sondazh, Franca u vlerësua si një "partner i besueshëm" nga 85% e gjermanëve, ndërsa Britania mori 78% – ndërkohë që SHBA-ja ra në vetëm 16%.

Shumë liderë evropianë bien dakord se Amerika e Trump-it tani përbën një kërcënim, edhe pse pak prej tyre e thonë hapur, për arsye diplomatike. Ata janë gjithashtu të vetëdijshëm për faktin shqetësues se aleanca transatlantike, tani në dekadën e saj të tetë, i ka bërë tepër të varur nga mbështetja ushtarake amerikane. Dhe kjo nuk është vetëm çështje parash. Varësitë më të rrezikshme lidhen me teknologjinë dhe armatimin amerikan.

Evropianët e shohin qartë në çfarë shtete të vështirë ndodhen ukrainasit pas vendimit të administratës Trump, për të ndërprerë rrjedhën e informacioneve të zbulimit dhe furnizimeve ushtarake. Prandaj, ata po ndjekin një strategji të dyfishtë. Nga njëra anë, duan të vonojnë shkëputjen e mbështetjes ushtarake amerikane për sa më gjatë të jetë e mundur; nga ana tjetër, po përgatiten për atë moment me ritmin më të shpejtë të mundshëm.

Kjo ishte logjika pas vendimit të javës së kaluar për t'i dhënë Komisionit Evropian autorizimin për të mbledhur 150 miliardë euro, për të



financuar industrinë e mbrojtjes së BE-së. Këto fonde pritet të përqendrohen në fusha ku vendet evropiane janë veçanërisht të varura nga SHBA-ja, si mbrojtja ajrore.

Lëshimi i borxhit të përbashkët evropian nuk është thjesht një mënyrë për të mbledhur para për mbrojtjen. Ai ofron gjithashtu mundësinë për të forcuar euron si një alternativë ndaj dollarit si monedhë rezervë globale. Paqëndrueshmëria e administratës Trump ka krijuar një kërkesë të konsiderueshme globale për një alternativë ndaj obligacioneve amerikane, si një aset i sigurt.

Tabuja ndaj borxhit të përbashkët evropian ka qenë tradicionalisht e fortë në Gjermaninë kursimtare. Megjithatë, ajo filloi të thyhet gjatë pandemisë. Tani ka shumë gjasa që të fshihet fare. Friedrich Merz, i cili do të jetë kancelari i ardhshëm i Gjermanisë, po lëviz gjithashtu për të përjashtuar shpenzimet kombëtare për mbrojtjen dhe infrastrukturën nga kufizimet kushtetuese të vendit të tij, për

deficitin buxhetor. Kujdesi fiskal i së kaluarës i jep Gjermanisë më shumë hapësirë për të marrë borxh, sesa Francës apo Britanisë, të cilat janë shumë më të zhytura në borxhe.

Një formë e Keynesianizmit ushtarak mund të rikthejë rritjen ekonomike në ekonominë më të madhe të Evropës. Një biznesmen i njohur francez e përmbledhni këtë me një ton ambiguiteti, duke thënë: "Është shumë e qartë. Gjermanët nuk munden të shesin makinat e tyre. Prandaj, do të prodhojnë tanke." Favori i fundit i Trump-it ndaj Evropës është përshpejtimi i afrimit mes BE-së dhe Britanisë së Madhe. Starmer dhe Emmanuel Macron, liderët britanik dhe francez, kanë bashkëpunuar ngushtë për Ukrainën. Ata mund të formojnë një triadë të fuqishme me Merz-in.

Një mekanizëm për të rritur shpenzimet ushtarake do të ishte krijimi i një fondi të ri evropian për mbrojtjen, në të cilin Britania mund të merrte

pjesë. Kjo do të krijonte një formë të re bashkëpunimi mes Mbretërisë së Bashkuar dhe BE-së, pa rihapur Kutinë e Pandorës së Brexit-it.

Mundësia për të riparuar disa nga dëmet e shkaktuara nga Brexit tregon se kjo nuk është thjesht një periudhë kërcënim për Evropën, por edhe një moment mundësie. Evropa tani mund të ofrojë një mjedis biznesi më të qëndrueshëm se Amerika e Trump-it – një ndryshim që mund të pasqyrohet në performancën e bursave të aksioneve në SHBA dhe Evropë.



Ndërsa administrata Trump intensifikon sulmin ndaj universiteteve amerikane, shfaqet mundësia për të tërhequr studiuesit kryesorë në Evropë. Hendeku midis pagave dhe fondeve për kërkime mes Amerikës së Veriut dhe Evropës është i madh, por shumë totale të përfshira janë të vogla kur krahasohen me shumë marramendëse të mbrojtjes.

Do të ketë mospajtime dhe pengesa në rrugën drejt unitetit më të madh evropian. Franca

dhe Gjermania tashmë po përplasen për mënyrën si do të shpenzohen fondet e reja të mbrojtjes së BE-së.

Çdo përplasje e tillë do të ushqejë skepticizmin e atyre që thonë se Evropa nuk do të arrijë kurrë të veprojë si një e tërë. Por historikisht ka pasur pengesa të ngjashme – në rrugën drejt krijimit të Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut në vitet 1950 dhe monedhës së vetme në vitet 1990. Por liderët evropianë arritën ta realizonin, sepse nevoja politike për unitet ishte shumë e madhe.

Të gjitha hapat e mëdhenj përpara për unitetin evropian kanë ardhur si rezultat i tronditjeve gjeopolitike – fillimisht pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe më tej, pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. Tani, me ndihmën e Trump-it, po përjetojmë fundin e aleancës transatlantike. Evropa u përgjigj me forcë dhe kreativitet ndaj dy sfidave të fundit të mëdha – dhe mund ta bëjë sërish. / financial times – bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Duka: Ne jemi bërë krenarë që Xhaka luan me Zvicrën, tani mërzitemi pse Brruti luan me Shqipërinë

**TIRANË, 12 MARS** - Presidenti i Federatës së Futbollit, Armand Duka, ishte i ftuari i parë në "Nazarko Podcast", një format i ri që sapo ka nisur, nën moderimin e Mentor Nazarkos dhe Oneda Skënderit. Gjatë bisedës presidenti Duka foli për rrugëtimin e tij në krye të Federatës, rritjen e institucionit, rolin e tij në UEFA dhe ndryshimet që kanë ndodhur në futbollin shqiptar. Ai theksoi se FSHF-ja ka kaluar një transformim të madh gjatë dy dekadave të fundit, duke u zgjeruar si institucion dhe duke ndikuar ndjeshëm në zhvillimin e futbollit në vend. Me investime të vazhdueshme në infrastrukturë, rritjen e numrit të futbollistëve dhe përmirësimin e organizimit të garave, FSHF-ja është sot një institucion modern me një vizion të qartë për të ardhmen. Gjithashtu, presidenti Duka foli për Kombëtaren, e cila është në prag të rrugëtimit të ri në kualifikueset e Kupës së Botës. Ai vuri në dukje se përfaqësimi dinjitoz i Kombëtares ka forcuar lidhjen mes shqiptarëve kudo në botë, duke e bërë futbollin një simbol bashkimi për kombin.

### Pjesë nga intervista e presidentit Armand Duka për faqen e Federatës Shqiptare të Futbollit:

*Si ka ndikuar përfaqësimi i lojtarëve nga Kosova, Maqedonia e Veriut, fakti që ata janë bashkuar me Kombëtaren në 'Euro 2016'?*

**Duka:** Kanë qenë gjithmonë vlerë e shtuar për ne, të gjithë futbollistët e diasporës. Kanë dhënë një kontribut të madh për Kombëtaren. Ne kemi hapur dyert e Kombëtares më herët se 2015, por pas 2015 në një numër më të madh. Ka pasur futbollistë me kualitet. Ka ndikuar pozitivisht dhe vijon të ndikojë pozitivisht. Ne nuk kemi ndërmend të ndryshojmë këtë politikë dhe të mbyllim derën për çdo shqiptar që dëshiron të luajë për Kombëtaren shqiptare. Ka shpesh diskutime, kritika, por ne do ta vazhdojmë këtë lloj politike, me derë të hapur për këdo që dëshiron të luajë dhe pa dyshim që e meriton të luajë.

*Pranimi i Kosovës në UEFA dhe FIFA?*

**Duka:** Pranimi i Kosovës në UEFA ka qenë një betejë e vështirë. Ne kemi lobuar si Federatë futbollit, kemi lobuar dhe mbështetur në të gjitha mënyrat, Federatën e Futbollit të Kosovës, edhe përmes anës

financiare që të pranohet. Lufta ka qenë e fortë dhe e ashpër sepse Kosova ka pasur shumë kundërshtarë dhe në fund ka fituar me një votë diferencë. Dhe ajo ka ndryshuar realitetin futbollistik në Kosovë sepse pa qenë anëtar i UEFA-s apo FIFA-s është vështirë të zhvillohet futbollit. Kemi bashkëpunuar me Federatën e Kosovës, me ish-presidentin e asaj kohe, legjendën e futbollit shqiptar, Fadil Vokrri.

*Kalimi i lojtarëve nga Kosova te Shqipëria (rasti i Brrutit)?*

**Duka:** Pashë një status të babait të lojtarit dhe mendoj që ishte i duhuri. Akuza për mua apo FSHF-në ka në të dyja drejtimet, pse e keni marrë këtë lojtar apo pse nuk e keni marrë. Edhe kur i merr, edhe kur nuk i merr, gjysma e njerëzve janë pro dhe gjysma kundër. Nëse je i bindur që ke bërë më të mirën, duhet të vazhdosh ta bësh. A e kam marrë unë Brrutin? Unë jam një nga ata që vendos për politikën e FSHF-së dhe një nga politikën tona është që dera e Kombëtares është e hapur për këdo. Ne marrim vetëm futbollistët shqiptarë, kushdo që ndihet shqiptar luan për ne.

*Marrëdhënia me FFK?*

**Duka:** Kam marrëdhënie të mira me të gjitha federatat e Evropës, kurse me Federatën e Kosovës kam marrëdhënie vëllazërore.

*Etnik Brruti?*

**Duka:** Në këndvështrimin sportiv, të gjithë ata që janë mbështetës të përfaqësueses së Kosovës mund të kenë një lloj të drejte, nëse futbollisti është një talent që mund të kishte kontribuar për ekipin që ata mbështesin. Në këtë këndvështrim kanë të drejtë. Në këndvështrimet e tjera nuk kanë të drejtë, sepse kushdo vendos vetë për veten. Nuk kemi pse mërzitemi, ne jemi bërë krenarë që Xhaka luan me Zvicrën, tani mërzitemi se pse Brruti luan me Shqipërinë. Brruti e ka marrë pasaportën dhe kemi aplikuar dhe për vizën angleze dhe uroj ta kemi në kohë.

*Reagimi i trajnerit të U-21 të Kosovës?*

**Duka:** Nuk besoj se ka futbollistë që e kanë ëndërr të shkojnë në Rusi, po pa dyshim që nuk mund ta refuzojë një klub rus. Futbollistët kanë ëndërr të shkojnë në perëndim, në Angli, Gjermani, Itali, Spanjë, Spanjë. Por nëse karriera i çon në Rusi, mund të luajnë dhe aty. Nuk është ai qëllimi, qëllimi i djalit është që i ka pëlqyer të luajë me Shqipërinë. Ka dhe një



shans të madh, ne do jemi pjesë e Kampionatit European U-21 2027. Nëse vazhdon karrierën mirë, do të luajë në finalen e këtij kampionati, në karrierë nuk të jepet shumë mundësia kur luan me ekipe relativisht të mesme apo të vogla. Çfarë i ofron Brruti Silvinjos? Teknikisht nuk e njoh, vendosin trajnerët, drejtori teknik i FSHF-së. Nuk e kam parë ndonjëherë. Nuk kam formimin e duhur për ta njohur teknikisht.

*Sa besoni te trajnerët ndërkombëtarë në krye të Kombëtares?*

**Duka:** Përderisa vazhdojmë me trajner të huaj, do të thotë që besojmë. De Biasi është një nga pikat historike të futbollit shqiptar. Për herë të parë jemi kualifikuar në një Evropian dhe as optimisti më i madh nuk e besonte që do kualifikoheshim. De Biasi ka një kontribut të madh në këtë kualifikim. Jo vetëm. Ka kontribut De Biasi dhe ndonjë tjetër, por kryesisht De Biasi në kulturën e punës dhe skuadrën Kombëtare të futbollit. Çdokush vë një gur, ndërsa De Biasi ka vë më shumë se një gur në zhvillimin e ekipit kombëtar të futbollit. Edhe Silvinjo ka meritë sepse dy herë në të gjithë historinë tonë jemi kualifikuar në Evropian. Dhe deri tani, emrat e De Biasit dhe Silvinjos do shkruhen në historinë e futbollit tonë si më të suksesshmit.

*Ndeshja me Serbinë në Tiranë, sa po punon FSHF-ja?*

**Duka:** Ekziston emocioni, peshë e historisë mes dy kombëtareve. Unë i ftoj të gjithë, besoj se do ta bëjnë të gjithë. Ta shohim ndeshjen me Serbinë si një ndeshje futbollit dhe asgjë më shumë. Objektivi ynë kryesor është që të fitojmë sportivisht. Nëse fitojmë sportivisht, i kemi fituar të gjitha.

*Organizimi i Euro U-21 2027 së bashku me Serbinë, reagimet?*

**Duka:** Në muajin maj 2025 do të presim finalen e Evropianit U-17. Është i pari Evropian që ne

presim, nuk kemi organizuar më parë një turne final. Më 31 mars hidhet shorti dhe nis më 19 maj. Jam i bindur që do të jetë një organizim i suksesshëm. Në 2027 do të presim finalen e Evropianit U-21. Ka qenë çështje diskutimi, jemi të vëmendshëm në kritikën dhe vërejtjet, sharjet e tifozëve se pse ne kemi bashkëpunuar me Federatën serbe për kampionatin. Ne jemi një organizatë sportive dhe ky është një event sportiv. Qëllimi kryesor është sportiv. Pa dyshim edhe pragmatist sepse ky ishte një shans për t'u shfrytëzuar për të pasur një kampionat evropian sepse unë dyshoj në historinë e Shqipërisë që do të përsëritet dhe uroj që të përsëritet sërish. Edhe nga ana politike, pa dyshim që jo vetëm e kam përjetuar atë që ka përjetuar çdo kosovar (jo në të njëjtën mënyrë sepse nuk kam qenë fizikisht në Kosovë), por të gjithë ne e kemi mbështetur dhe jemi munduar të lehtësojmë dhimbjen e shqiptarëve të Kosovës. E di historinë, por mesazhi është që ne duhet të shohim përpara. Ne nuk do ta ndryshojmë Serbinë, nuk do ta lëvizim Serbinë nga vendi. Ajo do të rrijë aty, Kosova do të rrijë aty. Pavarësisht dhimbjes, duhet të gjejmë mënyrën dhe duhet të gjejmë ura komunikimi. Nëse kjo do të ndikojë apo jo pak pozitivisht, unë besoj se po. Dhe nëse kjo i shërben përmirësimit të jetës së fëmijëve në Kosovë, unë do të jem i kënaqur. Do lëndoje disa sepse plagët janë të freskëta, por ne duhet të shohim përpara.

*Ju e përmendni si të sigurt kualifikimin në Botëror? Si e shihni?*

**Duka:** Gjithmonë është e vështirë, ai që mendon se ka fituar para se të fillojë loja, e ka të vështirë që ta arrijë. Por nuk kemi pse mos ta synojmë, ne i kemi kualitetet për t'u përballur në fushë. Jemi të përgjegjshëm për kundërshtarët që kemi. Kundërshtarët janë të gjithë të fortë, të 4, pavarësisht se thuhet

"Anglia, Anglia", por nuk mund të fitosh as kundër Andorrës nëse nuk ke përqendrimin maksimal, formën e duhur dhe angazhimin maksimal. Ne do të përpiqemi. Anglia është skuadër shumë e fortë, me objektiva për të qenë kampione bote, unë uroj mos ta lejojmë as të shkojë në Botëror. Serbia është skuadër e fortë gjithashtu, por edhe Letonia dhe Andorra nuk janë të lehta.

*Si ka ndikuar rritja e Kombëtares te shqiptarët që jetojnë jashtë Shqipërisë?*

**Duka:** Me keqardhje konstatoj që shqiptarët e Shqipërisë që emigrojnë jashtë, fëmijët e tyre nuk flasin të gjithë shqip, ndërsa shqiptarët e Kosovës, Maqedonisë dhe trojeve të tjera, nuk e kanë harruar asnjëherë gjuhën. Fëmijët e mikut tim nuk flasin gjuhën dhe nuk kishin dëshirë të vizitonin Shqipërinë dhe pas Evropianit, jo vetëm që kanë filluar të flasin shqip, por rinë me bluzën e Kombëtares së Shqipërisë dhe nga ajo kohë kanë ardhur pesë herë në Shqipëri, janë lidhur akoma me shumë me vendin. Kjo tregon se sa shumë i shërben kombit futbollit.

*A keni një strategji për ta zhvilluar ndjenjën kombëtare?*

**Duka:** Padyshim që promovimi është një pjesë e organizimit të rezultativitetit. Strategjia është të zhvillohesh dhe të kesh rezultate. Njerëzit shohin më shumë rezultatet e ekipeve kombëtare, sidomos Kombëtares A. Unë uroj që të bëjmë rezultate të mira. Njerëzit janë lidhur goxha me ekipin kombëtar, padyshim nga ndikimi i dy kampionateve evropiane, por edhe i ndeshjeve të tjera që zhvillon Shqipëria dhe jam i sigurt që do të vazhdojë kështu. Botërori është i vështirë, pasi shkojnë 16 skuadra, të paktën për këtë kampionat.

*A shitet bluza e Kombëtares jashtë Shqipërisë?*

**Duka:** Shitet më shumë jashtë Shqipërisë sesa brenda. Ne nuk i shesim vetë bluzat jashtë Shqipërisë, i shesim nëpërmjet sponsorit tonë Macron. Për "Euro 2016" janë shitur 100 mijë bluza. Tani për kualifikueset e Botërorit kemi përgatitur fanellën e re me motive popullore shqiptare, në të treja ngjyrat.

*Parashikim për ndeshjen në Londër?*

**Duka:** Do fitojmë ne, nuk po shkojmë për turizëm.

## Cavaliersi i pandalshëm në Lindje, Bucks i bie në sekondat e fundit

**OHIO, 12 MARS** - Skuadra Cleveland Cavaliers korri fitoren e 55-të sezonale në NBA, duke mundur me rezultat 109-104 Brooklyn Netsit dhe udhëheq renditjen e Lindjes. Për Cavaliersin u dallua Darius

Garland, autor i 30 pikëve. Në sekondat e fundit humbi skuadra e Milwaukee Bucksit, që u mund me rezultat 115-114 nga Indiana jashtë fushës. Shtatë lojtarë të Indianas realizuan mbi 10 pikë, ku mbi të gjithë

shkëlqeu Pascal Siakam me 25 pikë e 12 rebounde. Zhgënjeu Clippersit, që u mund me rezultat 127-120 nga New Orleansit, sfidë ku tre lojtarë të ekipit vendës realizuan mbi 20 pikë. Në fushën e tij fitoi Detroitit,

123-103 ndaj Washingtonit, ku protagonist ishte Cade Cunningham me 27 pikë e 10 asistime. Rezultatet: Cleveland - Brooklyn (109-104), Detroit - Washington (123-103), Indiana - Milwaukee (115-



114), New Orleans - Clippers (127-120).

## Malisheva deklason Gjilanin, Dukagjini mposht Prishtinën

EPOKA  
ERE

Veton ZYMBERI

**MALISHEVË, 12 MARS** - Skuadra e Malishevës ka shkëlqyer në përballje me Gjilanin, pasi e ka mposhtur me rezultat 4-1. Vendasit ishin më dominues, por golin e parë e shënuan vetëm në fund të pjesës së parë me anë të Arbër Prekazit. Pas pushimit, Malisheva sërish ishte skuadër më e mirë, duke shënuar në minutën e 56. Altin Aliu ishte realizues. Nëntë minuta me vonë, Oltion Bilalli ngushtoi rezultatit 2-1, po kjo ishte e tëra që e arriti Gjilani në këtë ndeshje. Në vazhdim të ndeshjes Aliu realizoi edhe dy gola të tjerë për ta kompletuar tregolëshin në këtë ndeshje shumë të rëndësishme. Pas



kësaj fitore, Malisheva barazohet me Ballkanin me nga 40 pikë, kurse Gjilani vazhdon të jetë në pozitën e katërt me 34 pikë.

Skuadra e Prishtinës po vazhdon me formë jo të mirë në Superligë. Sot është mposhtur nga Dukagjini me rezultat 0-1. Golin e parë dhe të vetmin në këtë ndeshje e realizoi Altin Mërlaku në minutën e 18. Prishtina është mundur të rikthehet në lojë, por asses nuk e arriti as golin e barazimit. Kjo skuadër është që nëntë ndeshje pa fitore.

Dukagjini dhe Prishtina kanë grumbulluar nga 31 pikë deri tash dhe ndajnë pozitën pesë dhe gjashtë. Të martën janë zhvilluar dy ndeshjet e tjera. Skuadra e Dritës ka bërë një hap gjigant drejt titullit të kampiones në Superligën e Kosovës në futboll, pasi e ka mposhtur Ballkanin (2-0). Forma jo e mirë e Llapit në Superligë ka vazhduar edhe në ndeshjen e fundit, ku ka pësuar humbje nga Ferizaj (2-1). Kjo xhiro përfundon të enjten me ndeshjen Suhareka - Feronikeli '74.

### SUPERLIGA

Prishtina - Dukagjini	0-1
Malisheva - Gjilani	4-1
Drita - Ballkani	2-0
Ferizaj - Llapi	2-1

Të enjten takohen:  
14:00 Suhareka - Feronikeli '74

## Verstappen: Mezi e pres rikthimin në pistë

**MELBURN, 12 MARS** - Pritja po mbaron dhe këtë fundjavë do të rikthehet Botërori i Formulës 1. Në Melburn të Australisë do të zhvillohet gara e parë sezonale dhe një nga protagonistët është padyshim katër herë kampioni i botës, holandezi i Red Bullit, Max Verstappen. Këtë vit ai do të ketë një shok të ri skuadre, neozelandezin Liam Lawson, me të cilin në krah do të shpeshojë për një titull të pestë, por edhe ta rikthejë Red Bullin në majën e renditjes pas zhgënjimit të sezonit të kaluar. "Është mirë të kthehesh të garosh dhe të fillosh zyrtarisht sezonin. Është mirë që gara e parë e sezonit është në Melburn, sepse këtu kam pasur garën time të parë në F1 dhe kam shumë kujtime të mira që kthehen në mendje", ka thënë Verstappen. "Në Bahrein mësuam shumë nga testet, por ka ende shumë punë për të bërë.



Ne kemi disa ide se çfarë të bëjmë dhe si të përdorim atë që kemi mësuar në para-sezon. Të shohim se si shkojnë gjërat kur të fillojmë të pilotojmë", ka shtuar holandezi. "Ne i analizuar të dhënat dhe punuar për të

kuptuar se ku mund të bëjmë përmirësime dhe ta optimizojmë sjelljen e makinës. Ne jemi gati të fillojmë përsëri dhe jam i emocionuar për ta filluar botërorin", ka përfunduar Verstappen.

## Slot: Ndeshje e përkryer, na mungoi vetëm goli

Liverpooli u eliminuar mbrëmë nga Liga e Kampionëve pasi është mposhtur pas penalltive nga Paris Saint-Germaini. Trajneri Arne Slot e ka analizuar humbjen e ekipit të tij, i cili i dha

fund shumë herët përvojës në këtë garë. "Ishte një paraqitje e jashtëzakonshme, ndoshta ishim të pafat sepse margjina e gabimeve në këtë nivel është aq e vogël. E bëjmë një lojë të përkryer,

përpos golit që nuk e shënuam. Ishte një ndeshje e ngjashme me atë në Paris javën e kaluar, kur e bënë ata një ndeshje të mirë dhe nuk shënuam. Dhe në vazhdimë ndoshta ata ishin më mirë", ka

thënë Slot. "Ishte ndeshja më e mirë e futbollit në të cilën unë kam bërë pjesë. Ishim mjaft të mirë dhe donim të shkonim sa më larg të jetë e mundshme, por kur u morëm vesh se do të

përballeshim me PSG-në, e dinim se do të ishte mjaft e vështirë. Në Paris luftuam, por fituam. Pamë një Liverpool mjaft të fortë, por jemi larg kompeticionit", ka shtuar Slot.

### SHKURT

#### Hapet zyrtarisht kampionati 'IHF Trophy Intercontinental'

Të mërkurën paradite është bërë hapja zyrtare e kampionatit "IHF Trophy Intercontinental". Kjo ngjarje, që është kualifikuese për Kampionat Botëror, po mbahet në Prishtinë. Garojnë gjashtë kombëtare në grupmoshën U18 dhe gjashtë të tjera në grupmoshën U20. Paraqiten të gjitha kontinentet. Kampionatin e shpalli të hapur Edin Kolgeci, president i Federatës së Hendbollit të Kosovës. "Në emër të FHK-së dhe në emër të timin u dëshiroj mirëseardhje të gjitha ekipeve kombëtare nga kontinentet e ndryshme që marrin pjesë në IHF Trophy Intercontinental. Në emër të FHK-së e falënderojmë IHF-në dhe zyrtarët e saj që janë këtu dhe të gjitha shtetet pjesëmarrëse. Ju dëshirojmë mirëseardhje dhe garë të suksesshme!", ka thënë Kolgeci. Kosova U18 luan sot (e enjte) nga ora 17:00.

#### Vëllai i Arbër Zenelit ftohet nga Suedia

Vëllai i Arbër Zenelit, Besforti, është ftuar nga Kombëtarja e Suedisë për dy ndeshjet e ardhshme të muajit mars. Suedia do të luajë gjatë marsit dy ndeshje miqësore. Në të parën vjen si mysafire e Luksemburgut më 22 mars. Në ndeshjen e dytë kombëtarja suedeze do të luajë si vendase ndaj Irlandës së Veriut më 25 mars. Për këto dy ndeshje përzgjedhësi Jon Dahl Tomasson ka publikuar tashmë listën me futbollistët e ftuar, ku nuk mungojnë befasishtë. Një nga to është ajo e Besfort Zenelit, i cili është vëllai i yllit të kombëtares së Kosovës, Arbërit. Mesfushori 22-vjeçar është duke shkëlqyer me skuadrën e tij Elfsborg dhe kjo ka bërë që ai të ftohet. Besforti ka qenë më parë ish-reprezentues i Kosovës U-21 ku ka zhvilluar gjashtë ndeshje me fanellën e "dardanëve".

#### Flick: Synojmë ta fitojmë Ligën e Kampionëve

Barcelona u kualifikua pas fitores edhe në ndeshjen e dytë ndaj Benficës (3-1). Trajneri Hansi Flick ka thënë se synim në këtë edicion është triumfi në Ligën e Kampionëve. "Jam shumë i lumtur për këtë kualifikim, por jam i lumtur mbi të gjitha për Yamalin. Kishte kohë që nuk shënonte. Faza çerekfinale? Është e rëndësishme që arritëm në këtë fazë, por ideja dhe objektivi ynë është ta fitojmë Ligën e Kampionëve. Sigurisht do të jetë e komplikuar, por ne dëshirojmë t'i shkojmë deri në fund", ka thënë Flicku.

#### Kompany: Mezi po e presim përballjen me Interin

Bayern Muncheni është kualifikuar në çerekfinale të Ligës së Kampionëve, pasi i fitoi të dyja ndeshjet ndaj Bayer Leverkusenit (5-0). Trajneri Vincent Kompany ka thënë se mezi e pret përballjen me kundërshtarin e radhës, Interin. "Në të vërtetë është një sfidë fantastike, por ka ende disa ndeshje në mes. Të shohim se si do të kthehen lojtarët pas pauzës së kombëtareve, atëherë do të mendojmë për Interin. Ne jemi në këtë turne pasi dëshirojmë të luajmë kundër më të mirëve. Mezi po e presim këtë përballje", u shpreh trajneri i Bayernit.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212) dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR 01/2024, Vendimit të datës 12.03.2025 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, K.R.M."Uniteti" Sh.A, vendosi që më datë 13.03.2025 të shpall:

**KONKURS**

**Një (1) Punëtor Fizik-** Njësia në Mitrovicë, me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi.

Numri i referencës: 12-03-46

Përgatitja profesionale: Diploma e shkollës fillore ose të mesme e preferueshme

Lartësia e pagës mujore: 382.36 € Bruto

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave në automjete – kamion kompaktor dhe traktor;
- Zbrazen e konteinerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre nga zona e shërbimit gjerë në deponi;
- Kryen pastrimin, larjen dhe spërkatjen e sipërfaqeve publike, rrugëve dhe shesheve;
- Kryen punët e grumbullimit të mbeturinave në konteiner, kryen punët rreth pastrimit të borës, hedhjes së kripës industriale, heqjen e akullit;
- Është i obliguar që të sjellë korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve;
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të konteinerëve gjatë punës, kryen edhe punë tjera të natyrës së ngjashme të cilat i cakton udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë.

**Kriteret e përgjithshme dhe procedurat e vlerësimit:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit. Të punësuarit punësohen për punë me orar të plotë të punës, i cili është 40 orë në javë, me kontratë pune (gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese në kohë të caktuar dhe varësisht nga performanca e të punësuarve dhe nevojave të kompanisë do të vazhdohet apo përthihet kontrata e punës). Procesi i vlerësimit përbëhet nga dy faza: verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit dhe në bazë të vlerësimit të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë. Kandidatët fitues do të shpallen kandidatët me më së shumti pikë të grumbulluara nga procesi i vlerësimit. Kalendarari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njejta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

**Aplikacionit i duhet bashkangjitur:**

- Formulari për aplikim i KRM"Uniteti"Sh.A-Mitrovicë
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar),
- Kopja e letërnjoftimit,
- Certifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës),
- Kopja e certifikatës/ekstratit të lindjes.
- Dëshmi nga gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 6 muaj).

**Afati dhe mënyra e Aplikimit:**

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njejtit në gazeta ditore, dhe atë nga data 13.03.2025 deri me 27.03.2025, ora 16:00. Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në zyrën e Arkivës të K.R.M."Uniteti" Sh.A në qytetin e Mitrovicës, në rr: "Vëllëzrit Dragaj"p.n, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Dorëzimi i aplikacionit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: [krmuniteti@yahoo.com](mailto:krmuniteti@yahoo.com)

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212) dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR 01/2024, Vendimit të U.D. Kryeshefit Ekzekutiv të datës 14.02.2025 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, K.R.M."Uniteti" Sh.A, vendosi që më datë 13.03.2025 të rishpall:

**KONKURS**

**Një (1) Vozitës i kategorisë "C"-** Njësia në Mitrovicë, me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi.

Numri i referencës: 14-02-32

Përgatitja profesionale: Shkolla e mesme

Lartësia e pagës mujore: 428.56 € Bruto

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Sipas Urdhërësës së Punës drejton automjetin dhe kujdeset për rregullësin, higjienën dhe pastërtin e tij;
- Është përgjegjës për vozitje të sigurt dhe për kryerjen me kohë, efikasë dhe kualitative të shërbimeve në bartjen e mbeturinave, larjen e rrugëve etj.;
- Në rastet kur e kryen terrenin e caktuar angazhohet në pika (zona), tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit-kryepunëtorit;
- Para daljes në teren merr Urdhërësen e Punës në të cilën evidencen punët e kryera , vërejtjet mbi pengesat dhe defektet në automjet, dhe të njejtën e kthen te dispeçeri;
- Vendos (monton) letërn e re të tahogرافit ndërsa letërn paraprake e kthen te dispeçeri, brenda 12 orëve;
- Vozitësi i cili e monton letërn e tahogرافit ka obligim që në të të shënon: Emrin e tij, numrin e regjistrimit të automjetit, datën dhe kilometrazhën fillestare dhe përfundimtare;
- Është i obliguar që në automjet të ketë mjetet e nevojshme të punës (lopata, fshisat etj.), për ekipën e punëtorëve me të cilët punon,largon(bartë) shtazët e ngordhura dhe i evidenton në urdhërësen e punës;
- Në rast nevojë ndrron gomat e automjetit në teren, apo në punëtorinë e mirëmbajtjes në bashkëpunim me gomisterin;
- Është i obliguar që prishjet në automjet me kohë t'i lajmon me shkrim te udhëheqësi i drejtpërdrejtë dhe në punëtorinë e mirëmbajtjes;
- Çdo sjellje të pandërgjegjshme të punëtorëve me të cilët punon vozitësi është i obliguar që ta paraqet te udhëheqësi drejtpërdrejtë;
- Vozitësi e njofton kryepunëtorin për kontejnerët e dëmtuar dhe sipas kërkesës së tij, bënë bartjen e tyre në punëtorinë e mirëmbajtjes për riparim;
- Është i obliguar që në Deponi të mbeturinave tu përmbahet rregullave dhe obligimeve të parapara në lidhje me procesin e punës në Deponi;
- Nëse automjeti me të cilin punon ndodhet në prishje apo jasht planit momental për përdorim, është i obliguar që të drejton automjetin tjetër , dhe të kryen punë tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit drejtpërdrejtë, nevojës së procesit të punës dhe interesit të ndërmarrjes;

**Kriteret e përgjithshme dhe procedurat e vlerësimit:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit. Të punësuarit punësohen për punë me orar të plotë të punës, i cili është 40 orë në javë, me kontratë pune (gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese në kohë të caktuar dhe varësisht nga performanca e të punësuarve dhe nevojave të kompanisë do të vazhdohet apo përthihet kontrata e punës). Procesi i vlerësimit përbëhet nga dy faza: verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit dhe në bazë të vlerësimit të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë. Kandidatët fitues do të shpallen kandidatët me më së shumti pikë të grumbulluara nga procesi i vlerësimit. Kalendarari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njejta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

**Aplikacionit i duhet bashkangjitur:**

- Formulari për aplikim i KRM"Uniteti"Sh.A-Mitrovicë
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar),
- Kopja e patentë Shoferit kategoria "C",
- Kopja e letërnjoftimit,
- Certifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës),
- Kopja e certifikatës/ekstratit të lindjes.
- Dëshmi nga gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 6 muaj).

**Afati dhe mënyra e Aplikimit:**

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njejtit në gazeta ditore, dhe atë nga data 13.03.2025 deri me 27.03.2025, ora 16:00. Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në zyrën e Arkivës të K.R.M."Uniteti" Sh.A në qytetin e Mitrovicës, në rr: "Vëllëzrit Dragaj"p.n, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Dorëzimi i aplikacionit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: [krmuniteti@yahoo.com](mailto:krmuniteti@yahoo.com)

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.



**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letërn Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

**RESTAURANT**

**SWISS**

**TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Marash Dedaj nga Lug Bunari Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Mjekësisë Gjakovë.
- Doli SH.P.K. nga Gjakova shpall të pavlefshme nr. Fiskal 812041961 të lëshuar nga ARBK.
- T.D.A.P. SH.P.K. nga Gjakova shpall të pavlefshme nr . Unik Identifikues 811125881 të lëshuar nga ARBK.
- Zoje Karaqi Doblbare Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e sh.m.u. "Dëshmorët Lleshi" Doblbare Gjakovë nga kl. 1-8.
- Teuta Pula nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Benita Thaqi nga Xërxe Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Krenar Gazija nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Hasan Arifi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX sh.f.m.u. " 28 Nëntori " Brodosan.
- Fatlind Imeraj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI- IX sh.f.m.u. " Dëshmoret e Hasit" Kabash i Hasit.
- Esmir Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat Q.K "11 Marsi" Prizren.
- Vahid Cocaj shpall te pavlefshme dëftesat sh.f.m.u. " Zenun Cocaj " Gjonaj.
- Dashurije Osmankaj shpall te pavlefshme dëftesat sh.f.m.u. " Pjeter Budi " Lubizhd e Hasit.
- Lirije Pajaziti shpall të pavlefshme Licencën e Punës të lëshuar nga Oda e Infermierëve të Kosovës me nr. KO-8808-05-21. Motër e Anestezionit.
- Lirije Pajaziti shpall të pavlefshme Licencën e Punës të lëshuar nga Oda e Infermierëve të Kosovës, drejtimi Bachelor i Shkencave në Infermieri Teknik i Anestezionit, me nr. KO-42777\A-06-20-17.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

